



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit

P- 029

Prishtinë, më 19 qershor 2008, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
19 QERSHOR 2008**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 74 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ndërkohë, Organi i pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, i formuar me vendim të Kuvendit, datë 16 maj 2008, ka përfunduar shqyrtimin e kandidaturave, të propozuara nga Qeveria dhe Kuvendit i ka rekomanduar listën e kandidatëve, për emërim.

Kryetari propozoi që, për arsye të urgjencës që ka emërimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, të radhitet si pikë e fundit e rendit të ditës.

Kryetari e hodhi në votim propozimin për radhitjen e pikës shtesë të rendit të ditës.

Kuvendi me shumicë votash miratoi propozimin që shqyrtimi i Raportit të Organit të pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik të jetë pika e fundit e seancës së sotme.

Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, me kërkesë të ministrit të Tregtisë dhe të Industrisë, Lutfi Zharku, i cili gjendet në udhëtim zyrtar jashtë vendit, propozoi që të tërhiqet nga rendi i ditës shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit 2004/48 për administratën tatimore dhe procedura.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-së.

Kuvendi, me shumicë votash, miratoi propozimin që shqyrtimi i parë të Projektligjit për ndryshimin e Ligjit 2004/48 për administratën tatimore dhe procedura të hiqet nga rendi i ditës së seancës së sotme.

Zëvendëskryeministri, Ramë Manaj, propozoi që pika e dytë – Koha për pyetje parlamentare- të hiqet nga rendi i ditës të seancës së sotme me arsyetimin se shumica e ministrave, që u janë parashtruar pyetje parlamentare, janë në udhëtime zyrtare jashtë vendit.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e zëvendëskryeministrit.

Kuvendi, me shumicë votash, nuk e miratoi propozimin e zëvendëskryeministrit që pika e dytë të hiqet nga rendi i ditës.

Kryetari e hodhi në votim tërheqjen e pikës së pestë nga rendi i ditës - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/48 për Administratën tatimore dhe procedurat, me arsyetimin se mungonte ministri përkatës për ta arsyetuar këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Kuvendi, me shumicë votash, miratoi propozimin që pika e pestë të hiqet nga rendi i ditës të seancës së sotme.

Deputeti Driton Tali propozoi që në rend dite të seancës së sotme të përfshihet edhe një pikë shtesë - Kuvendi të diskutojë dhe të marrë qëndrim lidhur me letrën e Sekretarit të OKB-së, zotit Ban Ki Mun.

Kryetari tha se kërkesa duhet të parashtrohet me shkrim.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 2 e 3, 4, 5 dhe 11 qershor 2008,
2. Koha për pyetjet parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për armët,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përfitimet e ish-zyrtarëve të lartë,
5. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë të Ekonomisë dhe të Financave për ridestinimin e mjeteve për investime kapitale nga Projekti: “Kompleksi i ri Qeveritar” për Projektin: “Rinovimi i Pallatit të Mediave”,
6. Shqyrtimi i Raportit të Organit të pavarur për emërimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 2 e 3, 4, 5 dhe 11 qershor 2008

Procesverbalet e seancave plenare të mbajtur më 2 e 3, 4, 5 dhe 11 qershor 2008 u miratuan pa vërejtje.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja **Drita Kadriu** i parashtoi pyetje ministres së Drejtësisë lidhur me veprimet e kësaj ministrie për të mundësuar funksionimin e gjykatave në veriun e Kosovës.

Ministrja **Nekibe Kelmendi** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Kadriu**.

Deputetja **Suzanë Novobërdaliu** i parashtoi pyetje Kryeministrit lidhur me atë se çfarë masash ka marrë Qeveria për t'i parandaluar vetëvrasjet në Kosovë?

Përgjigjja mbeti për seancën e radhës, ngase Kryeministri nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja **Suzanë Novobërdaliu** i parashtoi pyetje Kryeministrit lidhur me atë se çfarë masash ka ndërmarrë Qeveria për punësimin e personave të moshës ndërmjet 45 dhe 65 vjetëve?

Përgjigjja mbeti për seancën e radhës, ngase Kryeministri nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja **Drita Maliqi** i parashtoi pyetje Kryeministrit lidhur me suspendimin e shërbyesve civil në Administratën e komunës së Gjilanit.

Ministri **Arsim Bajrami** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Maliqi**.

Deputetja **Luljeta Shehu** i parashtoi pyetje ministres së Energjetikës dhe të Minierave lidhur me mundësitë e shlyerjes së borxhit për shpenzimin e energjisë elektrike për familjet e dëshmorëve, të familjeve me persona të pagjetur dhe të atyre me nevojë sociale.

Përgjigjja mbeti për seancën e radhës, ngase ministrja Justina Pula nuk ishte e pranishme në seancë.

Pyetjet që nuk morën përgjigje në seancën e sotme, mbetën për të marrë përgjigje në seancën e radhës.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për armët

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta prezantojë Projektligjin për armët.

Ministri i Punëve të Brendshme, **Zenun Pajaziti**, në emër të Qeverisë tha se nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji është e madhe për faktin se në Kosovë ekziston një numër mjaft i madh i armëve ilegale. Me këtë projektligj rregullohen kushtet për: shitblerjen, posedimin, mbajtjen, ruajtjen, prodhimin, riparimin, paaftësimin, qarkullimin, ndërmjetësimin, transportin dhe bartjen e armëve brenda territorit të Kosovës, si dhe eksportin, importin dhe transitin për persona fizikë dhe juridikë.

Projektligji ka 13 kapituj me gjithsej 86 nene. Projektligji krijon një stabilitet legjislativ për veprimtarinë të cilën e rregullon.

Projektligji për armët ka implikime buxhetore që vlerësohen të jenë përafërsisht prej 1.638.810 euro. Me këtë projektligj, përveç shpenzimeve, krijohen edhe të hyra buxhetore nga licencat dhe forma të tjera, nga të cilat planifikohen të realizohen rreth 1.900.000€ për periudhën 2008 – 2010. Projektligji është në pajtim me legjislacionin e BE-së.

Në fund, ministri **Pajaziti** i ftoi deputetët ta miratojnë këtë projektligj.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e këtij projektligji, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Projektligjin për armët dhanë: në emër të Komisionit për Punë të Brendshme e Siguri dhe të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Shkumbin Demaliaj**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Rrustem Mustafa**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Fatmir Rexhepi**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Naim Maloku**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli** dhe në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Zylfi Merxha**, si dhe deputeti **Riza Smaka**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----75
Kundër----- 0
Abstenime-----1

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për armët.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri – si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion e Gjyqësi, Komisionin për Buxhet e Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përfitimet e ish-zyrtarëve të lartë

Kryetari i informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për përfitimet e ish-zyrtarëve të lartë, si dhe me raportet e komisioneve kryesore dhe të komisionit përgjegjës raportues. Ai ftoi kryetarin e komisionit funksional që ta arsyetojë Raportin dhe rekomandimet para deputetëve të Kuvendit.

Deputeti Bahri Hyseni tha se pas tërheqjes së këtij projektligji nga seanca e kaluar, me kërkesë të Grupit Parlamentar të PDK-së, Komisionit për Legjislacion e Gjyqësi dhe ai për Buxhet e Financa kanë formuar dy nënkomisione, të cilat edhe njëherë e kanë shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe pasi që i kanë shqyrtuar, veç e veç, të gjitha amendamentet, të dy komisionet janë pajtuar që Kuvendit të Kosovës t’i paraqesin amendamentet me rekomandimet, që u janë shpërndarë deputetëve.

Kryetari hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1,2,3,4,5,6,7, 8,9,10 dhe 11.

Pastaj, Kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 70;

Kundër----- 0.

Abstenime-----6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për përfitimet e ish-zyrtarëve të lartë.

6. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për ridestininimin e mjeteve për investimet kapitale nga Projekti: “Kompleksi i ri Qeveritar” në Projektin: “Rinovimi i Pallatit të Mediave”

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit me kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, të cilën Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar dhe e ka përkrahur.

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta arsyetojë kërkesën para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Arsim Bajrami** tha se Qeveria e Kosovës ka miratuar Planin rezidencial për akomodimin e institucioneve shtetërore nga objektet private në objekte publike dhe Ministria e Shërbimeve Publike ka hartuar Planin rezidencial dhe dinamikën e punimeve që gjatë këtij viti të realizohet kjo objektivë strategjike.

Ministria e Shërbimeve Publike do ta implementojë këtë plan në tri faza. Faza e parë ka filluar të implementohet dhe në tetor do të kemi vendosjen e pesë ministrive nga shtëpitë private në objekte publike. Në fazën e dytë mendohet që procesi të vazhdojë me rinovimin e Pallatit të Mediave, ku është miratuar plani për vendosjen e 5 ministrive dhe 800 zyrtarëve. Faza e tretë është ndërtimi i Kompleksit qeveritar, që është miratuar nga Qeveria e kaluar, dhe kjo fazë parasheh ndërtimin e 10 godinave reprezentative me standarde evropiane, që parashihet të ndërtohet në një kompleks të ri, në Prishtinën e re, në lagjen Ajvalia.

Rreth këtij projektit të tretë, MSHP ka filluar menjëherë përgatitjet e nevojshme dhe ka kontakte të vazhdueshme me autoritetet komunale, që t’i përfundojnë punët rreth planit urbanistik. Mirëpo, për shkaqe objektive, Komuna e Prishtinës nuk ka arritur që sivjet ta bëjë planin e plotë urbanistik në lagjen Ajvalia, ku do të fillojë ndërtimi i Kompleksit qeveritar. Për këtë arsye, i është rekomanduar Ministrisë së Financave që të bëjë një ndryshim në Projektligjin për buxhetin dhe të bëjë një ridestinim të mjeteve nga pozicioni “Kompleksi qeveritar”, në pozicionin “Pallati i Mediave”.

Për ridestinimin e mjeteve për pozicionet e cekura më lart, sipas ligjit në fuqi, kërkohet pëlqimi i Kuvendit dhe Ju ftoj që ta mbështetni.

Kryetari hapi diskutimin lidhur me kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, **Gani Koci**, tha se Komisioni ka marrë këtë kërkesë me datë 22.04.2008 dhe e ka shqyrtuar atë dhe i rekomandon Kuvendit që ta miratojë kërkesën për ridestinimin e mjeteve nga projekti kapital “Kompleksi i ri i objekteve të Qeverisë”, nën kodin buxhetor 100012, në shumën prej 8.411.478 euro, në projektin kapital: “Rinovimi i Pallatit të Mediave” në shumë prej 7.494.479 euro. Kërkesën e Ministrisë e mbështet edhe Grupi Parlamentar i PDK-së.

Lutfi Haziri tha se për Grupin Parlamentar të LDK-së dinamika nën fazën dy, që e ka paraqitur Qeveria, i ka dy probleme serioze. Problemi i parë serioz ka të bëjë me pronësinë e këtij objekti, sepse sipas Ligjit për Agjencinë e Privatizimit, titullar i vetëm i pronës shoqërore është kjo Agjenci.

Fillimi i punimeve të kësaj ndërtese është ndërprerë me kërkesën e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit.

Nën dy, rreth këtij objekti kemi kontestin gjyqësor, i cili ende nuk është i mbyllur.

Si rast i tillë, unë kërkoj nga Qeveria që t'i ketë parasysh këto probleme serioze, që u cekën më lart, para se të investojë në këtë objekt.

Ibrahim Gashi, në emër të Grupin Parlamentar të AKR-së, tha se e mbështesim, në parim, këtë kërkesë të Ministrisë. Mirëpo, edhe Grupi ynë Parlamentar i ka shqetësimet dhe vërejtjet e ngjashme me ato që i ngriti Grupi Parlamentar i LDK-së lidhur me çështjen e pronësisë së objektit në fjalë, e cila mendojmë se patjetër duhet të jetë paraprakisht e definuar qartë para se të investohet. Kemi edhe një vërejtje të vogël - kostoja. Nëse për ndërtimin e objektit qeveritar është parashikuar shuma prej 8.4 milion e diçka euro, si është e mundur që rinovimi e një objekti, që është si konstruksion i gatshëm, të kushtojë vetëm 1 milion € më pak? Me këto dy vërejtje e mbështesim kërkesën e ministrisë.

Ardian Gjini, në emër të Grupit të AAK-së, tha se kanë dilemë për tri çështje lidhur me kërkesën e ministrisë. E para, ne e konsiderojmë këtë kërkesë si kthim prapa prej një plani i cili ka ekzistuar për ndërtimin e kompleksit. E dyta, nëse shkohet kështu, nuk besojmë se do të mund të përfundohet ashtu si duhet. Çështja e tretë, është çështja e pronësisë, për të cilën Qeveria e kaluar ka qenë e detyruar ta ndërpresë atë, me kërkesë të AKM-së.

Për këto arsye, ne nuk do ta votojmë këtë propozim.

Berim Ramosaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, tha se mbështet shqetësimet e Grupit Parlamentar të LDK-së dhe atij të AAK-së. Mirëpo, për kërkesën e Ministrisë së Financave për alokim të mjeteve është dashur të sigurohet dokumentacioni përkatës. Nuk qëndron as leja, nuk është sqaruar as titullari i atij objekti. Ai objekt nuk është publik, por është objekt shoqëror, sepse pronësia shoqërore dhe publike dallojnë shumë.

Së pari, duhet të sqarohet çështja e titullarit të këtij objekti dhe e objekteve të tjera, e atëherë mund të bëhet edhe alokimi i mjeteve. Andaj, Grupit Parlamentar i LDD-së nuk e mbështet kërkesën e Ministrisë.

Sadik Idriz, në emër të Grupit Parlamentar “7+” tha se problem për shumicën e grupeve parlamentare lidhur me kërkesën e Ministrisë është çështja e pronës. Edhe Qeveria e mëparshme, anëtar i së cilës kam qenë, i ka ndërprerë punimet në atë objekt për shkaqe të padefinuara të pronësisë.

Nuk është problem që të votojmë, por problemi qëndron në atë se si t'i bindim deputetët që të votojnë për një gjë, kur nuk është e zgjidhur çështja e pronësisë dhe kur ministri i Financave nuk është i pranishëm për të dhënë sqarime. Ne do ta mbështesim këtë kërkesë nëse bindemi se nuk do të ketë probleme me çështjen e pronës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave për ridestinimin e mjeteve për investimet kapitale nga Projekti: “Kompleksi i ri Qeveritar” në Projektin: “Rinovimi i Pallatit të Mediave” dhanë edhe këta deputetë: **Riza Smaka, Naim Maloku, Bahri Hyseni, Gjylnaze Sylja, Numan Baliq, Naser Rugova, Adem Hajdaraj, Gani Buçinca, Vezira Emrush, Ibrahim Makolli, Melihate Tërmkolli, Lulzim Zeneli dhe Synavere Rysha**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Pas këtij debati, Kryetari e hodhi në votim kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----19,
Kundër-----33,
Abstenime-----15.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, nuk e miratoi kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për ridestinimin e mjeteve për investimet kapitale nga Projekti: “Kompleksi i ri Qeveritar” në Projektin: “Rinovimi i Pallatit të Mediave”.

6. Shqyrtimi i Raportit të Organit të pavarur për emërimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik

Kryetari i njoftoi deputetët e Kuvendit me Rekomandimin e Organit të pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit, i cili është themeluar me Vendim të Kuvendit, të datës 16 maj 2008, edhe ka shqyrtuar listën për 5 kandidatë të propozuar nga Qeveria për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe Kuvendit ia ka rekomanduar listën për 3 kandidatë për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit, si vijon:

- Hysni Hoxha,
- Tefik Sylejmani dhe
- Demë Keka.

Dy kandidatët e tjerë, nga 5 të propozuarit, aq sa janë paraparë me Ligj, Ahmet Krasniqi dhe Lulzim Blakaj, sipas Organit të pavarur të përzgjedhjes nuk i kanë plotësuar kushtet e parapara në nenin 96 pika 5 të Ligjit për prokurimin publik.

Kryetari hapi debatin lidhur me Rekomandimin e Organit të pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare kërkuar që kjo pikë të shtyhet për seancën e radhës me arsyetimin se Raporti me rekomandim i Organit të pavarur përzgjedhës dhe biografite të kandidatëve të propozuar për Organin Shqyrtues të Prokurimit u janë shpërndarë me vonesë dhe nuk kanë pasur kohë të mjaftueshme për t’i shqyrtuar ato.

Kuvendi, me kërkesë të grupeve parlamentare, këtë pikë e shtyu për seancën e radhës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 14:00.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale